



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2024:006571

Datë: 25.03.2025

Numri i dokumentit: 07042378

C.nr.2175/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Skender Shala, në çështjen juridike kontestimore të iniciuar me padinë e paditëses B.V. nga Mitrovica, të cilën sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson av. Fitim Gashi nga Prishtina, kundër të paditurës KM - DKA, të cilën me autorizim e përfaqëson Lirim Zeka, avokat në komunën e Mitrovicës, me objekt kontesti kompensim i diferencës për gradimi – kualifikim licencim, vlera e kontestit 1,273.05 €, jashtë seance gjyqësore me datë 25.03.2025 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditëses B.V. nga Mitrovica, kundër të paditurës KM - DKA për objektin e kontestit kompensim i diferencës për gradimit – kualifikim licencim, si e bazuar.
- II. DETYROHET e paditura që paditësit në emër të diferencës së pagës për gradim në lartësi 27 % të pagës bazë në shumë prej 421.00 €, shumën mujore prej 55.35 €, për periudhën kohore nga data 01.04.2021 deri 27.12.2023, për 21 muaj, t'ia kompensoj shumën prej 1,273.05 €, të gjitha këto me kamatë ligjore në lartësi prej 8% nga data e paraqitjes së padisë 27.12.2023, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 120€, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e marrjes së formës së prerë të aktgjykimit me kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.
- III. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar që në emër të licencimit – kualifikimit për periudhën kohore nga data 01.01.2018 deri më 31.03.2021, dhe atë për 39 muaj që të DETYROHET e paditura KM - DKA t'ia paguaj shumën prej 2,158.65 € , të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, si e pabazuar.

## A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të tij, më datë 28.01.2025, ka paraqitur padi, në këtë gjykatë, kundër të paditurës, me objekt të kontestit kompensim në emër të diferencës në të ardhura personale për kualifikim, me vlerë të kontestit 1,273.05 €, me kamatë ligjore prej 8 % nga data e parashtrimit të padisë në gjykatë deri në pagesën definitive, si dhe t'i kompensoi shpenzimet e procedurës.

Në padi ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune në shkollën e mesme fillore të ulët “Andon Zako Çajupi” në pozitën mësimdhënëse e ciklit klasor. Ka shtuar se me kontratën e punës e njehta figuron si Bachelor i Programit Fillor, ndërkaq edhe përkundër kësaj e njehta nuk ka marrë asnjë kompensim në emër të diferencës në të ardhura personale për kualifikim.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë, fillimisht vërejtë se padia është përpiluar në tërësi në përputhje me dispozitën nga neni 253, lidhur me nenin 99 të LPK, pas plotësimit të kushteve ligjore, të njëjtën (padinë me dokumentet e bashkangjitura në të), më Aktvendimin që mbanë shenjen C.nr.642/2023, datë 01.11.2024, e ka detyruar të paditurin që brenda afatit ligjor prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, të paraqet përgjigje në padinë e paditëses nën paralajmërimin për pasojat procedurale nëse nuk veprohet konform këtij Aktvendimi.

E paditura me datë 28.01.2025 ka paraqitur pranë kësaj gjykate përgjigje në padi, duke e kundërshtuar në tërësi të pabazuar kërkesën për kompensimin në emër të licensimit, me pretendimin që për periudhën të cilën paditësja e kërkon kompensimin nuk ka bashëngjitur si dëshmi listat e pagave për periudhën kontestuese, ashtu siç e kërkon neni 7, paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore i cili përcakton që *“Palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat do të konstatohen faktet e tilla”*.

Gjithashtu e paditura pretendon që koform nenit 87 të Ligjit të punës, me të cilin përcaktohet se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”* dhe bazuar në këtë kërkesa për kompensimin në emër të kualifikimit për periudhën para datës 27.12.2020 është parashkruar.

Gjykata për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike ka vlerësuar provat si në vijim: kontrata e punës e datës 01.09.2016, diploma universitare e datës 29.03.2023, licenca e mësimdhënësit e datës 31.03.2021, transaksionet bankare për periudhën kohore 01.09.2022 deri 30.09.2021.

Gjykata, pas administrimit të provave, ka bërë shqyrtimin e tyre veç e veç si dhe të ndërlidhura si tërësi mes veti, mbi bazën e bindjes së saj të lirë në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk ishte kontestuese në mes palëve ndërgjygjëse, se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, fakt të cilin nuk e kanë kundërshtuar as pala e paditur. Nga licenca e lëshuara nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe lista e pagave nga Buxheti i Republikës së Kosovë rezulton se paditësi është licencuar me Licencë Karriere. Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në faktin se me Kontratën Kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës - Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 49 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit) kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023. Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësit t’ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit

ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, rezulton se e paditura, në emër të diferencës së pagës për gradim në lartësi 27 % të pagës bazë në shumë prej 421.00€, shumën mujore prej 55.35 €, për periudhën kohore nga data 01.04.2021 deri 27.12.2023, për 21 muaj, t'ia kompensoj shumën e pëgjithshme prej 1,273.05 €.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartëcekura në kuptim të nenit dhe 399 të LPK-së i cili parasheh se : *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit jashtë seance ashtu që me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku duke gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Lidhur me kamatën ligjore të kërkuar nga paditësi, duke qenë se e paditura, ka rënë në vonesë lidhur me pagesën e borxhit të krijuar, gjykata ka vendosur që kamatë vonesa të jetë prej 8%, duke u bazuar në nenin bazuar në nenin 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtimit padisë në gjykatë (08.11.2024), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur nga paraqitja e padisë është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, marrë parasysh faktin që licensa e karrierës e paditëses është lëshuar me datë 31.03.2021, ndërsa paditësja kërkon kompensimin në emër të licensimit-kualifikimit për periudhën e cila nuk është e përfshirë në këtë licensë.

Gjithashtu gjykata vlerësoi se janë plotësuar kushtet për të vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi bazuar në nenin 399 të LPK-së i cili shprehimisht parasheh se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.”*

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452 paragrafi 1 të LPK, sipas të cilit pala e cila e humb kontestin tërësisht ka për detyrë që, palës kundërshtare, t’ia kompensojë

shpenzimet gjyqësore. Në rastin konkret pala e paditur ka për obligim që paditëses të ia paguaj shpenzimet procedurale në emër të përpilimit të padisë, në shumën prej 120 Euro, dhe në emër të taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro.

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë si dhe duke u bazuar në nenin 398 dhe 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti Përgjithshëm- Divizioni Civil

C.nr.2175/2023 datë 25.03.2025

Gjyqtari:  
Skender Shala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.